

## Programi 'Qelizat e reja/Young Cells'

### Pvetjet e Shpeshta dhe Përgjigjet

#### 1. Çfarë lloj mbështetje ofron ky program?

Programi 'Qelizat e reja/Young Cells' ofron mbështetjen e mëposhtme për kandidatët që do të përzgjidhen:

- **Mbështetje financiare:** mbulimi i shpenzimeve për leksionet dhe trajnimet, përfshirë dhe kurset e gjuhëve të huaja, shpenzimet financiare të jetesës gjatë praktikës 10 javore dhe vizitave studimore 2 javore në vendet pritëse (akomodim+transport publik+shpenzimet për ditë/dieta), fluturimet ndërkombëtare nga Tirana drejt vendeve ku do të kryhen praktikat dhe vizitat studimore.
- **Sigurimet:** gjatë periudhës së qëndrimit jashtë vendit, të gjithë pjesëmarrësve do t'iu mbulohet siguracioni i shëndetit si dhe siguracioni civil (civil liability).
- **Mbështetje praktike:** këshillim i kandidatëve të përzgjedhur për të zgjedhur institucionin publik në vendet ku do të zhvillohet praktika e punës, si dhe ofrimi i ndihmës së vazhdueshme përgjatë gjithë kohëzgjatjes së programit.
- **Mentorimi** do të ofrohet në administratën/institucionin/shërbimin e vendit të origjinës së kandidatit, me qëllimin që të ndiqet zhvillimi i tij/saj në karrierë.

#### 2. Cili është kalendari i pritshëm i zbatimit të aktiviteteve të programit 'Qelizat e reja/Young Cells'?

1. Trajnimet do të fillojnë gjatë mesit të muajit shtator 2023 dhe do të zhvillohen deri në mes të muajit dhjetor 2023. Programi trajnues do të organizohet dhe mbahet nga ekspertë të BE-së, pjesë e konsorciumit (INSP, UASK, UNIBO, EKKDA, DSJU) në bashkëpunim me ASPA (online dhe në Tiranë)
2. Praktika 10 javore e punës në një nga 5 vendet anëtare të BE-së do të zhvillohet në periudhën 8 janar 2024 deri më 15 mars 2024.
3. Vizitat studimore do të zhvillohen në periudhën 18 mars 2024 deri më 29 mars 2024.
4. Aktivitete të caktuara:
  - Aktivitet vizibiliteti- në fillim të muajit shtator 2023;
  - Seminar përmbyllës-në muajin maj 2024;
  - Aktivitet për Alumni dhe rrjetëzim- nga muaji prill 2024 e në vazhdim.

#### 3. A duhet ta pezulloj statusin e nëpunësit civil gjatë periudhës së praktikës së punës në vendet e BE-së?

Nuk është e nevojshme të pezullohet statusi i nëpunësit civil gjatë pjesëmarrjes tuaj në program. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 12.3.2014, "Për Rregullat e Organizimit dhe të Funkcionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, Trajnimit e Nëpunësve Civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil" (i ndryshuar), Kreu IV, pika 4 dhe Kreu V, pika 2: *'Trajnimi jashtë vendit, i organizuar nga institucioni, është me shkëputje nga puna. Gjatë periudhës së trajnimit deri në tre muaj, nëpunësi merr pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune'.*

#### **4. A përfshin punë/ngarkesë ekstra pjesëmarrja në program?**

Aktivitetet e ndryshme të mësimit dhe leksionet, përfshirë dhe kurset e gjuhëve të huaja, mund të organizohen pas orarit zyrtar, pas orës 16:00, gjatë ditëve të javës. Pritet që pjesëmarrësit e përzgjedhur të vetëpërgatiten përpara pjesëmarrjes në sesionet e trajnimit (përshebull gjatë fundjavës), vecanërisht gjatë ndjekjes së shkollës online në vjeshtë.

#### **5. A duhet të kem statusin e nëpunësit civil për të aplikuar në këtë program?**

Po, duhet të kesh statusin e nëpunësit civil për t'u bërë pjesë e këtij programi. Një nga kriteret e kualifikimit për këtë program është akti i konfirmimit si nëpunës civil (sigurohuni të jetë pjesë e dosjes tuaj të aplikimit).

#### **6. Kam marrë statusin e nëpunësit civil por aktualisht punoj në një institucion që rregullon marrëdhënien e punës me Kodin e Punës, a mund të aplikoj në këtë thirrje?**

Jo, nuk mund të aplikoni në këtë thirrje pasi një nga kushtet e kualifikimit është që nëpunësi të jetë aktualisht duke ushtruar funksione të nëpunësit civil, në një nga institucionet pjesë e shërbimit civil.

#### **7. A konsiderohet eksperiencë pune periudha e provës në shërbimin civil?**

Po, konsiderohet si eksperiencë pune.

#### **8. Me çfarë dokumenti e provoj eksperiencën time nga 3 deri në 8 vite pune në administratën publike, deri në datën e aplikimit ?**

Dokumenti është librezë e punës e plotësuar (e firmosur dhe e vulosur) që provon eksperiencën tuaj 3-8 vite pune në administratën publike, e cila duhet të jetë pjesë e dosjes tuaj të aplikimit.

#### **9. Pasi kam dërguar aplikimin, ku duhet të bazohem për përgatitjen për procesin e përzgjedhjes?**

Përveç 2 anekseve bashkëlidhur thirrjes, ju mund t'iu referoheni dokumentave kryesore që lidhen me Reformën në Administratën Publike në Shqipëri, si dhe me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian duke iu referuar këtyre burimeve:

<https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik>

[https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/key-findings-2022-report-albania\\_en?s=214](https://www.eeas.europa.eu/delegations/albania/key-findings-2022-report-albania_en?s=214)